



MË SHPEJTË, MË LARTË, MË FUQISHËM—NGRITJA E POTENCIALIT TË RITJES SË EQLJL

Tetor 2013

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Sikurse në rajonet tjera me tregje në zhvillim, **tregjet financiare në Evropën qendrore, lindore dhe juglindore (EQLJL) kanë qenë në presion** që nga pranvera. Shtetet me baza më të dobëta dhe ato që kanë pasur të hyra më të larta të mëhershme janë prekur më së shumti. Përgatitjet për një krizë të re, që do të mund të shndërrohej në presione të konsiderueshme financiare për disa shtete, janë thelbësore.

Kriza gjithashtu paraqet rrezik të rimëkëmbjes. EQLJL ka filluar ta merr veten pas rënies së dytë në katër vite, duke përfituar nga forcimi i eurozonës. Rritja zhgënjyese do të zgjeronte hendekun e vogël të prodhimit që është hapur viteve të fundit. Megjithatë, hapësira për politika kundër-ciklike është e kufizuar në shumë vende, meqë deficitet fiskale ende janë të larta, borxhi publik ende ka trend në rritje dhe presioni në normat e këmbimit mund të kufizojë hapësirën për politika monetare.

Rritja e dobët nuk është problem i kohëve të fundit. Gjatë pesë viteve të fundit, rritja në EQLJL nuk ka përmbushur pritjet e mëhershme. BPV është rritur për vetëm ½ për qind në vit mesatarisht, shumë më pak se parashikimi prej 5 për qind i bërë pranverën e vitit 2008. Performanca e ngadaltë më së shumti buron nga një potencial shumë më i ulët i rritjes, kryesisht për shkak të investimeve shumë më të dobëta nga kompanitë, për shkak të kërkesës më të ulët për produktet e tyre, disponueshmërisë më të ulët të financimit, si dhe një nevojë për të rregulluar bilancet e tyre të gjendjes si pasojë e një bumi të paqëndrueshëm të investimeve para krizës.

Shikuar drejt së ardhmes, **pengesat për rritje të prodhimit janë të konsiderueshme**, që do ta bëjnë më të vështirë uljen e papunësisë dhe sjelljen e raporteve të borxhit publik në nivele më të pranueshme. Rrjedhat e kapitalit, posaçërisht nga bankat amë në Evropën Perëndimore, me gjasë do të mbesin të ulëta, rritja tek partnerët tregtarë në EQLJL parashihet të jetë modeste, dhe rënia e popullatës në moshë të punës pritet të përshpejtohet.

Prandaj, arritja e rritjes “më të shpejtë, më të lartë, më të fuqishme” është thelbësore dhe kërkon hapa vendimtarë në:

- **Trajtimin e trashëgimive të krizave.** Një sektor i shëndetshëm financiar është vendimtar në sigurimin e kredive dhe promovimin e rritjes. Zvogëlimi i pengesave në fushën ligjore, gjyqësore, tatimore dhe rregullative për zgjidhjen e kredive të këqija do të lehtësonte ristrukturimin

industrial dhe spastrimin e bilancit bankar. Rindërtimi i tamponëve fiskalë do të ulë primet e riskut dhe kostot e huamarrjes, me efekte për t'u përshëndetur për sektorin privat.

- **Nxitjen e sektorit të tregtueshëm.** Rritja më e balancuar do të avanconte perspektivën e rritjes. Studimet empirike tregojnë se ekonomitë më të hapura rriten më shpejtë. Integrimi më i afërt në zinxhirët globalë të furnizimit do të sjellë një transferim më të shpejtë të teknologjisë dhe konvergjencë të përshpejtuar të të ardhurave.
- **Përmirësimin e klimës për investime.** Thjeshtësimi i rregulloreve dhe forcimi i konkurrencës, mbrojtja e investitorëve dhe zbatimi i kontratave janë prioritete në shumë shtete. Në disa syresh, ristrukturimi dhe/apo privatizimi i ndërmarrjeve të mëdha shtetërore që punonin në humbje dhe avancimi i qeverisjes dhe transparencës janë me rëndësi të madhe.
- **Sigurimin e një tregu funksional të punës.** Papunësia e lartë ka një komponentë të madhe strukturore, që ka qenë shqetësuese që nga periudha e hershme e tranzicionit. Avancimi i politikave aktive të tregut të punës do ta përmirësojë riaftësimin dhe ripozicionimin e punonjësve. Reformat në aftësimin profesional dhe shkollimin e lartë gjithashtu mund të jenë të nevojshme, sikurse edhe shënjetstrimi më i mirë i asistencës sociale për papunësi dhe programeve sociale, për t'i avancuar rezultatet në tregun e punës.